



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data:2024

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1, DATË 26.10.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
RREGULLATOR"**

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, nenit 20, pika 1, shkronja "d", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e një anëtari, Komisioni Rregullator,

VENDOSI:

- I. Në vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:
 1. Titulli i vendimit ndryshon si më poshtë:
"Për miratimin e Rregullores së mbledhjeve të Komisionit Rregullator".
 2. Pika 1 ndryshon si më poshtë:
"1. Miratimin e Rregullores së mbledhjeve të Komisionit Rregullator, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi."
- II. Në tekstin e Rregullores, miratuar me vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:
 1. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:
 - a. Shkronja "c" e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:

"c) Ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të marrë masa për njoftimin e mbledhjes dhe dërgimin e materialeve të mbledhjes tek anëtarët e Komisionit Rregullator, përfaqësuesit e partive politike parlamentare, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe personat e tretë sipas rastit.
 - b. Shkronja "a" e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:
"a) t'i kërkojë informacion, dokumentacion dhe mbështetje, si dhe t'i lërë detyra

Data: . .2024 Nr:
Ora:



Për disa shtesa dhe ndryshime në
vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të
Komisionit Rregullator

sipas nevojave administratës së KQZ-së, e cila ka detyrimin t'u përgjigjet kërkesave dhe të vërë në dispozicion kopje të çdo dokumentacioni që administrohet nga KQZ, sipas kërkesës.

c. Pas shkronjës "b" të pikës 2 shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje: "b/1. Të kërkojë praninë në mbledhjet e Rregullatorit të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhorë, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara dhe me përvojë në fushën e zgjedhjeve si dhe çdo subjekt që ka interes të ligjshëm për projektaktin që shqyrtohet."

2. Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"7. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mbështetet dhe asistohet nga administrata e KQZ."

3. Në nenin 17, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Në çdo rast, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mund të thërrasë për shpjegime zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së që kanë lidhje me projektaktin që shqyrtohet."

4. Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 33 Forma e aktit

1. Akti i miratuar nga Komisioni Rregullator është i shkruar dhe përmban:

- a. Stemën e Republikës së Shqipërisë;
- b. Emrin e institucionit (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve);
- c. Logon e institucionit (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve);
- d. Emrin e organit që nxjerr aktin (Komisioni Rregullator);
- e. Titullin e aktit;
- f. Preambulën e aktit ku përfshihen dispozitat e kompetencës së nxjerrjes së aktit, dispozitat autorizuese për nxjerrjen e aktit si dhe propozuesi i aktit;
- g. Përmbajtjen e aktit;
- h. Emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje;
- i. Mënyrën e votimit të secilit anëtar (pro/kundër);
- j. Numrin, datën dhe orën e miratimit.

2. Akti nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje, pasi të kenë verifikuar përmbushjen e vullnetit të tyre të shprehur me votë."

5. Pika 2 e nenit 34 shfuqizohet.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: . .2024 Nr:
Ora:



Për disa shtesa dhe ndryshime në
vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të
Komisionit Rregullator